

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nufi: Mbrojtja civile nuk mund të bazohet vetëm te reagimi, por edhe te parandalimi
ADRESA	https://kohajone.com/aktualitet/nufi-mbrojtja-civile-nuk-mund-te-bazohet-vetem-te-reagim-i-por-edhe-te-parandalimi/
BURIMI	kohajone.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 15:28:44 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 15:23:12 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a9bd3f5f1a9a18ce39924d47acfc5c59e154d5a61fd582dd14a972d34fa0a38b
TEKSTI	0527a8ce58ab4bba529091ebd60d8f8629613e0e05f175ab7100964be0c9d660
PAMJA	69aafa47641132c9c5b15bbd4c47d241410992717299d81edcd724d4551c14ce

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	732d051b18ddbcde086150f98e81e8fdded9e94af586b2d44a3fb891830e0ca27
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7da1a16455667271a66d1d30122b5a20135397a682b3b58f5cc074dfa4984ea9
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/732d051b18ddbcde086150f98e81e8fdded9e94af586b2d44a3fb891830e0ca27>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Nufi: Mbrojtja civile nuk mund të bazohet vetëm te reagimi, por edhe te parandalimi

AKTUALITET E ENJTE, 17 SHTATOR 2026 17:23



Ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi, ka kërkuar forcimin e masave parandaluese dhe të standardeve të sigurisë nga zjarri, duke theksuar se mbrojtja civile nuk duhet të fokusohet vetëm te reagimi pas emergjencave.

Gjatë hapjes së konferencës ndërkombëtare "Tirana Fire Safety 2026", që po zhvillohet në Tiranë me pjesëmarrjen e ekspertëve, institucioneve publike, akademisë dhe përfaqësuesve të industrisë së ndërtimit e teknologjisë, Nufi tha se siguria duhet të planifikohet që në fazën e projektimit të ndërtesave.



"Nuk mund ta ndërtojmë mbrojtjen civile vetëm mbi reagimin. Ne duhet të jemi po aq të fortë në parandalim, sa ç'jemi edhe në reagim", deklaroi ministri.

Duke iu referuar zhvillimit të shpejtë urban dhe ndërtimit të strukturave gjithnjë e më komplekse, Nufi nënvizoi nevojën për rritjen e standardeve të sigurisë nga zjarri.

"Sigurinë s'mund ta marrim si të mirëqenë dhe siguria s'mund të jetë asnjëherë një mendim i mëvonshëm. Ajo duhet të projektohet që në fillim!", u shpreh ai.

Ministri bëri të ditur se, deri më 9 shtator 2026, sistemi i mbrojtjes civile është përballur me 81 raste zjarresh masive, të cilat kanë kërkuar angazhimin e më shumë se 14,600 forcave, rreth 1,350 mjeteve tokësore dhe janë realizuar 180 operacione ajrore.

Sipas Nufit, pas këtyre shifrave qëndrojnë orë të gjata pune dhe sakrifica të forcave dhe strukturave të ndryshme të angazhuara në përballimin e emergjencave.

Ai vlerësoi angazhimin e Forcave të Armatosura, shërbimeve zjarrfikëse, pushtetit vendor, Policisë së Shtetit, shërbimeve pyjore, administratave të zonave të mbrojtura dhe vullnetarëve.

"Pas këtyre shifrave janë njerëz, orë pune, sakrifica dhe një përpjekje e përbashkët e Forcave të Armatosura, shërbimeve zjarrfikëse, strukturave të pushtetit vendor, Policisë së Shtetit, shërbimeve pyjore, administratave të zonave të mbrojtura

LAJMET KRYESORE



Prefekti i Tiranës, Shkëlqim Hajdari nga Times Square: Të gjithë bashkë, për një qëllim, liri për çlirimtarët!



Ministria Spahiu në Kuvend: Në janar 2027 sjell Pet Scan-in tek Onkologjiku ose jap dorëheqjen!



Përplasja në protestë, qytetarët bllokojnë rrugët. Disa të shoqëruar



Nikoll Lesi: Pabesia e Hagës, dënoi aleatët që Perëndimi i përdori kundër Millosheviçit



Kosovë: Reagime pas dënimeve ndaj ish-krerëve të UÇK-së. Goditen ambasadat e huaja në Prishtinë

TË PËRZGJEDHURA



Edmond Spaho te Nikoll Lesi: PD ka mbaruar, nuk vjen ne pushtet!



Luka Modric konfirmon pjesëmarrjen me Kroacinë në Ligën e Kombeve



Dëshirat e Spallettit dhe blerjet e Juventus-it



Tesla, drejtimi gjysmë-autonom drejt përshtatjes me rregullat evropiane, thotë Franca



Shpërthen Erion Braçe te Nikoll Lesi në KOHA JONË-DEBAT: Nuk votoj kandidat me "njoftim"!

MË TË LEXUARAT

vullnetarëve dhe të gjithë aktorëve të tjerë të sistemit", tha Nufi

Ministri theksoi se sistemi i mbrojtjes civile, në zbatim të ligjit për mbrojtjen civile, vendos në qendër zvogëlimin e riskut, parandalimin, gatishmërinë, koordinimin dhe aftësinë ripërtëritëse të komuniteteve.

Në konferencë u nënvizua gjithashtu rëndësia e bashkëpunimit mes institucioneve publike, ekspertëve dhe sektorit privat. Sipas ministrit, siguria nga zjarri kërkon standarde të qarta, projektim të sigurt, zbatim korrekt, inspektim efektiv dhe përdorim të teknologjive moderne.

Mund të jetë një imazh i tekstit që thotë "TFS ERMAL MINISTER OF DEFEN ILBANIA TIRANA INTERNATIONAL TIRANAIN SEPT"

MË SHUMË NGA AKTUALITETI



Kundërshtoi pezullimin e afateve të paraburgimit, Apeli rrëzon kërkes...

"Dyfisho Sipërmarrjen Tënde", Ibrahimaj: 1700 biznese kanë shfaqur in...


Ministrja Spahiu në Kuvend: Në janar 2027 sjell Pet Scan-in tek Onkol...



Protestuan në zonën e Zogut të Zi, Gjakata e Tiranës liron personat e...



Kumbaro: Shqipëria mirëpret Bordin e PISA-s për herë të parë në Tiranë



Përplasje në protestë, qytetarët bllokojnë rrugët. Disa të shoqëruar

LAJMET E FUNDIT



Nufi: Mbrojtja civile nuk mund të bazohet vetëm te reagimi, por edhe te parandalimi

[5 MINUTA MË PARË](#)



Foda reagon pas çështjes Rrahmani: Ka shumë dramë, po ekzagjerohet ...

[18 MINUTA MË PARË](#)



Veteranët e UÇK-së sërish në protestë në Prishtinë: Kundërshtojmë Gjykatën Speciale

[34 MINUTA MË PARË](#)



Haçka në Kuvend: Dënimet e ish-krerëve të UÇK-së ishin shumë të rënda, historia nuk



FIFA bllokoi sërish merkaton e Tiranës, nuk shpëtojnë as Flamurtari e Kukësi



Shkoi me pushime në Velipojë, 82-vjeçari nga Kosova humb jetën në det

filloi në Hagë

57 MINUTA MË PARË

1 ORË E 6 MINUTA MË PARË

53 MINUTA MË PARË

MË SHUMË LAJME TË FUNDIT >

KOHA JONE

Gazeta "KOHA JONË" themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991

Botues: Nikoll LESI. Adresa e redaksisë: Rruga "Samë Frasheri", Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA

TË FUNDIT

LAJME

SPORTI

EKONOMI

EDITORIAL

WEBTV

AKTUALITET

RAJONI

KOSOVA

BOTA

TEKNOLOGJI

SHOWBIZ

SHËNDETI

SOCIALE

TURIZËM

KURIOZITETE

KULTURA

HISTORIKU

KONTAKT

BOTUES & DREJTOR: Nikoll LESI

KRYEREDAKTOR: Daniel MUÇAKU

ZV/KRYEREDAKTOR: Redjon SHTYLLA

BORDI: Elsa KAMBERI, KRYETARE

NIPT: J71425013C



NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA

SD

© 2024 KOHA JONE. All rights reserved.

PRIVACY POLICY

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.